


fake  
news

Lajmet

e rreme,

kërcënimi i

Demokracisë



Ky publikim është përgatitur me përkrahjen e Fondacionit Konrad-Adenauer, Zyra në Prishtinë.

Përgatitur nga:



Përkrahur nga:



E drejta e autorit © 2019. Demokracy Plus (D+)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Demokracy Plus dhe Konrad-Adenauer Stiftung. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetei elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+. Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim nuk paraqesin qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer.

# fake news




**S**hoqëria njerëzore po kalon një tranzicion të çuditshëm, ku frika nga sulmet bërthamore është transformuar në frikë nga mashtrimet dhe manipulimet përmes lajmeve të rreme.

I GJITHË GLOBI KA DREJTUAR VËMENDJEN NË MBROJTJEN NGA KËTO LAJME TË PAVËRTETA, APO SIÇ NJIHET TERMI “**FAKE NEWS**”.

Potenciali për të prodhuar dhe përkrahur lajme të tilla ka dëshmuar se mund të ndërhyjë në procese madhore dhe të bëjë dëme të paprecedenta, madje edhe të rrëzojë apo ndërrojë qeveri të një shteti.

Përderisa shkencë ende nuk e ka dhënë definicionin e saktë se çka është “Fake News” apo lajmet e rreme, shpërndarja e tyre ka shkaktuar pasoja të mëdha për shoqëritë, përfshirë edhe Kosovën. Një definicion i cili është krijuar në vitet e fundit i ka përcaktuar lajmet e rreme si: “Informacione të pavërteta të cilat pretendohet të jenë lajme për të cilat autori e di se janë të pavërteta dhe i shpërndanë me qëllim të influencës politike ose përfitimit financiar për veten ose për të tjerët”.

Lajmet e rreme janë përdorur dhe do përdoren për të ndryshuar mendimin e qytetarëve veçanërisht gjatë kohës së zgjedhjeve ku propaganda në internet rritet me faqet e reja dhe ueb-portalet e hapura para fushatës.



Përdorimi i lajmeve të rreme për interesa politike, po ashtu ka krijuar dëme të mëdha veçanërisht në tensionet ndëretnike në vend.

Biznesi dhe konkurrenca po ashtu e kanë përdorur median për të mundur konkurrencën dhe dëmtuar produktet e konkurrencës.

Elementi kryesor që e bën informacionin një lajm të rremë është mjeshtëria që ai të duket si lajm i vërtetë dhe që lexuesi mos të arrijë ta kuptojë që informacioni është i sajuar.

Prapa kësaj mjeshtërie renditen algoritme dhe përdorues të rremë të rrjeteve sociale të cilët shpërndajnë informacionin për të rritur lexueshmërinë e tij në internet dhe për të krijuar përshtypjen se informacioni është lexuar e besuar nga mijëra njerëz.

Si rrjedhojë, prodhuesit e lajmeve të rreme kujdesen që informacionin ta sajojnë me burime të cituara duke e plasuar para publikut si informacion të vërtetë. Ata sigurohen që mos të lënë dilema para lexuesve, ku numri i madh i shpërndarjeve (shares) dhe komenteve e bën informacionin në dukje edhe më interesant për lexuesit.



Format e shpërndarjes së lajmeve të rreme





1

## LAJMET PËR KURIOZITETE

**J**anë forma më e përhapur e lajmeve të rreme të cilat synojnë të ndikojnë audiencën.

“A e dini se banka .... ka falimentuar në vendin e origjinës? A e dini se Xhorxh Uashington është shqiptar? Arsyeya pse policia i ka gati autobлиндat?, etj.”

Janë disa prej titujve që i hasim çdo ditë në media sociale e të cilat synojnë që fillimisht të ngjallin kuriozitetin e lexuesit e më pas të ofrojnë edhe informacione të rreme rreth tyre.


Në lajmet për kuriozitete përfshihen dhe lajmet satirike të cilat po ashtu janë informacione që mbërthejnë audiencën e të njëjtat synojnë përhapjen e informacioneve të rreme duke përdorur satirën dhe humorin, si pasojë edhe keqinformohet publiku.

2

## LAJMET POLITIKE

**L**ajmet e rreme politike apo për politikën bëjnë pjesë në kategorinë më të rrezikshme të lajmeve të rreme.

Kundërkandidatët politikë brenda vendit apo shtetet që kanë armiqësi mes vete krijojnë informacione të pavërteta për kundërshtarët, të cilat i përhapin tek audiencia brenda dhe jashtë vendit. Informacionet se ky politikan është i njohur për bashkëpunimin me Serbinë apo shërbimin inteligjent serb dhe informacione që ky politikan është i lidhur me Qeverinë e Kosovës, apo AKI-në, janë lajme të cilat mbysin audiencën në media shqiptare e serbe para dhe pas zgjedhjeve.



Për t'`u dukur të vërteta këto informacione shoqërohen me gjoja dokumente e deklarata të njerëzve të cilat po të kontrollohen dalin të jenë anonime apo të panjohur për publikun.

Informacionet e tilla përkrahen nga partitë dhe kundërshtarët politikë brenda vendit, por bota ka njohur edhe raste kur lajmet e tilla janë paguar nga shtetet e tjera të interesuara për të ndërruar strukturën qeverisëse të një vendi – shteti tjetër.

Në Ballkan tashmë është vërtetuar tendenca e prodhimit të lajmeve të rreme për llogari të agjendave të Rusisë dhe radikalëve islam të ISIS.

Përdorimi i terminologjisë së lajmeve të rreme nga politikanët ballkanikë po ashtu ka dëmtuar reputacionin në publik të mediave serioze. Duke ndjekur narrativin e presidentit amerikan, Donald Trump, pushtetarët kanë nisur t'`i quajnë

si lajme të pavërteta lajmet kredibile të mediave hulumtuese.

Fake News ka dëmtuar edhe imazhin e mediave serioze, ku shpesh kanë qenë edhe viktimë e portaleve fantome, të cilat i kanë ripublikuar informacionet e paverifikuara të këtyre të fundit.

Ky term është bërë i njohur viteve të fundit, ku në vitin 2017 është quajtur edhe "fjala e vitit", për shkak të përdorimit të madh nga presidenti i SHBA-ve, Trump.

Kjo formë e veprimit rritë abuzimin me lajmet e rreme, për shkak se audienca e lajmeve të rreme mund të jetë më e madhe dhe operimi në një ambient të pakontrolluar u ofron akoma më shumë mundësi prodhuesve të këtyre lajmeve që të ndërtojnë narrative të cilat synojnë që raportimet e vërteta hulumtuese t'`i diskreditojnë.


3

## LAJMET PËR HISTORINË

**N**ë realitetin e Kosovës ku historia e vendit është shkruar në librat e historisë në dy ose tri versione, lajmet e rreme për ngjarjet historike janë zhvilluar tej mase. Historia e vendit mësohet në dy versione, në versionin shqiptar dhe në versionin serb, të cilat kanë kundërtënë të shumta mes vete. Ndikimi në lajmet e historisë vjen edhe nga faktorë të tjerë të jashtëm, të cilët nuk janë shqiptarë e as serbë.

Ndikimi turk në prodhimin e lajmeve për historinë e qeverisjes osmane në Ballkan ka prodhuar mijëra informacione historike të cilat nuk kanë asnjë bazë ose fakt të konfirmuar nga historianët.

E njëjta gjë ka ndodhur edhe me të kaluarën e komunizmit dhe historisë së shkruar për shekullin e 20-të, ku lajme të pabazuara në fakte vazhdojnë ta keqinformojnë publikun për ato çfarë kanë ndodhur realisht gjatë këtij shekulli.





Nuk do ta  
besoni se çfarë  
zbuloi qytetari  
në këtë market

4

## LAJMET PËR EKONOMINË DHE KONKURRENCËN




**K**onkurrenca në ekonomi përpos investimeve në marketing e ka parë si mundësi të mirë krijimin e lajmeve të rreme për konkurrentët me qëllim që t'ua dëmtojë biznesin. "Nuk do ta besoni se çfarë zbuloi qytetari në këtë market", "Zbulohen krimba në këtë ushqim", "Kjo bankë mund të falimentojë", etj, janë disa nga titujt të cilët janë publikuar në mediat tona e të cilët për qëllim kanë favorizimin e një konkurrenti tjetër duke e dëmtuar reputacionin e biznesit për të cilin është shkruar lajmi i rremë. Sidoqoftë, ekziston një vijë e hollë në mes informacioneve të cilat tregojnë për keqpërdorime të bizneseve në shitje dhe prodhim. Lajme të tilla duhet të prodhohen me kujdes dhe duke konsultuar të gjitha burimet, në të kundërtën rreziku i dezinformimit është i madh.

5

## RRITJA E AUDIENCAVE

**P**lasimi i informacionit të sa më shumë qytetarë - lexuesë është qëllimi kryesor i prodhuesve të lajmeve të rreme. Duke arritur numër të madh lexuesish ata njëkohësisht përhapin propaganda të rreme politike dhe ekonomike, por nga ana tjetër fitojnë edhe shuma të konsiderueshme të parave përmes shfaqjes së reklamave. Për ta rritur këtë audiencë, këta persona që shpesh nuk e kanë si profesion fare gazetarinë përdorin strategji të ndryshme.





# 100000000 000000Likes

Hapi i parë është dukja e faqeve si faqe serioze dhe të vërteta, ky është elementi i parë në të cilin investojnë prodhuesit e lajmeve të rreme.

Emërtimet si "fakte mbi....gazeta...., shqiptarët e....", etj., përdoren për të thithur audiencë të cilat janë të interesuara për informacione të tilla.

Përmbajtja e faqeve të lajmeve të rreme nuk nënkupton që ato do publikojnë vetëm lajme të rreme.

Investimet e para të këtyre faqeve janë që të publikojnë lajme të vërteta, ndërsa veç pas krijimit të audiencës dhe besimit të dhënë nga lexuesit fillojnë të publikojnë lajme të rreme.

Përdorimi i "bots" apo krijimi i profileve të rreme për ta shtuar lexueshmërinë po ashtu është veprim i zakonshëm i krijuesve të lajmeve të tilla.

Profile të rreme në Facebook, Instagram ose në rrjete tjera sociale krijojnë qarkullueshmëri në faqet e rreme me qëllim që tek audiencë e gjerë këto faqe të duken si të ndjekura dhe komentuara nga shumë lexues.

Gjithashtu, rishpërndarja e materialit të profileve të rreme rrit prezencën e lajmit dhe zgjeron audiencën akoma më shumë.

Lajmet e rreme janë të konceptuara si lajme që shpërndahen në rrjetet sociale, ndërsa investimet për to nuk janë vetëm në formën e shkruar. Për të arritur qëllimin e tyre, prodhuesit e lajmeve të rreme, veçanërisht në kohë të fushatave politike përdorin materiale filmike për të arritur agjendat e tyre.

Ndër lajmet më të hasura në këtë kohë në audiencën

tonë janë videot me tituj si "Ja çka thonë analistët për këtë parti politike". Këto lajme prodhohen nga deklaratat e njerëzve nga të cilat merren vetëm sekuenca të shkurtra që prodhuesit të lajmit të rreme i intereson, e jo në kontekstin se si është thënë deklarata.

Dëmet nga materialet video janë më të mëdha sesa dëmet nga materialet e shkruara. Kjo për shkak se qytetarët janë të prirur ta besojnë një material të cilin e shohin me pamje, e dëgjojnë dhe në fund edhe e lexojnë.

## 6

## KONTEKSTI KOSOVAR I LAJMEVE TË RREME

**E**dhe pse në dukje të aktuale, në gjithë botën, lajmet e rreme janë përdorur për të shtyrë agjendat që nga themelimi i mediave tradicionale si radio apo televizioni.

Mediat u përdoren për të promovuar lajme dhe nxitur qytetarët në shoqëritë komuniste duke krijuar histori të rreme për heronjtë e socializmit dhe luftëtarët që sakrifikonin veten para kauzave të mëdha.



Skena mediale në Kosovë ishte dominuar në periudhën para viteve 90-ta nga mediat e kontrolluara nga shteti e të cilat funksiononin nën mbikëqyrjen e partisë komuniste.

Aty personifikoheshin lajme të cilat kishin edhe përmbajtje të pavërteta për sukseset e partisë komuniste e ndërmarrjeve shoqërore.


Tranzicioni dhe masat e dhunshme pas viteve të 90-ta nxorën në skenë mediat shqiptare dhe ato serbe, të cilat krijuan dy realitete të kundërta për atë çfarë po ndodhte në Kosovë.

Deri në vitin '99, qytetarët serb u bombarduan me lajme të rreme për aktivitete terroriste nga shqiptarët. Lajmet se fshatra serbe po sulmoheshin nga shqiptarët, kroatët e boshnjakët dhe pamjet e fshatarëve duke mbajtur pushkë gjuetie në vetëmbrojtje ishin të pranishme çdo natë në televizionin shtetëror të asaj kohe.

Në anën tjetër, mediat shqiptare duke tentuar të përkrasin luftën e UÇK-së nisën me publikimin e informacioneve të pavërteta për suksese në terren të UÇK-së, të cilat numëronin qindra policë të vrarë serbë, informacione këto që dilnin të ishin trillime.

Paslufta në vend u shoqërua me themelimin e mediave të pavarura, por që një pjesë e tyre ishin të lidhura me partitë politike. Si rrjedhojë, u krijuan gazetatat të cilat ishin të pavarura redaktorialisht dhe gazetatat të cilat, meqenëse ishin të lidhura me partitë politike, mbronin partinë financuese dhe shkruanin lajme të rreme për partitë e tjera.

Në mungesë ndëshkimesh dhe trajtimit të padive për shpifje, gazetatat arritën të mbijetonin deri në fund duke arritur edhe procesin e transformimit të tyre nga media të shkruara në media online.



## “Kosova është e lirë falë luftës së NN politikanit”

Sot në vend janë të regjistruara mbi 400 media online, ndërsa vetëm 30 prej tyre janë të anëtarësuar në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK), të cilat synojnë zbatimin e rregullave të përcaktuara nga ky këshill. Kjo e dhënë tregon për nivel të ulët të vullnetit për t'ju nënshtruar kontrollit të ruajtjes së etikës dhe dispozitave të Ligjit për Shpifje. Rreziku i këtyre mediave është evident veçanërisht në kohë të fushatave parazgjedhore, ku aktivizimi i tyre bën që të shpërndahen mijëra informacione të pasakta për kandidatët në zgjedhje. Informacionet e prodhuara në kohë zgjedhjesh në këto portale shfaqen në dy forma, informacione të pavërteta që kanë qëllim promovimin e politikanëve e po ashtu informacione të pavërteta të cilat kanë për qëllim degradimin e disa prej tyre.

Shembull janë informacionet të cilat i promovojnë politikanët si personat meritore për veprime të caktuara, si lufta apo punë të infrastrukturës - si shtrimi i asfaltit apo ndërtimi i shkollave, me tituj të stilit “Kosova është e lirë falë luftës së NN politikanit” apo “Autostrada u bë falë veprimeve të NN Ppolitikanit”. Gjithashtu, pjesë e lajmeve të tilla denigruese janë edhe ndërlidhja e kandidatëve të caktuar dhe bashkëpunimi i tyre me Serbinë, apo edhe informacione të pavërteta mbi familjet ose të bëmat e politikanëve.

# MEKANIZMAT PËR LUFTIMIN E FAKE NEWS

Shoqëritë botërore nuk e kanë të definuar një mekanizëm i cili me automatizëm do i luftonte lajmet e rreme dhe ndëshkonte prodhuesit e tyre.

Fakti se sot, çdo përdorues i rrjeteve sociale mund të prodhojë dhe shpërndajë lajme e ka bërë të pakontrollueshme situatën.

Megjithatë, janë ndërmarrë hapa në drejtim të identifikimit të faqeve të rreme dhe profileve të rrejshme, ku disa prej tyre janë mbyllur sidomos pas problemeve me fushatën presidenciale në ShBA.

Edukimi i lexuesve dhe platformat e "fact-checking" janë dy mekanizmat kryesorë me të cilët sot luftohen lajmet e rreme.

Qytetarët dhe lexuesit duhet të vetëdijësohen në këtë drejtim dhe të ndërmarrin hapa për verifikimin e burimit të lajmit të cilin e lexojnë.

Informacionet e lexuara duhet të kontrollohen për emrin e autorit, burimet e informacionit të cituar, e deri te vendi ku janë publikuar.



## SI TË IDENTIFIKOJMË?

**Emri i autorit:** Prodhuesit e lajmeve të rreme zakonisht nuk publikojnë emrin dhe të dhënat e tyre si fotografia apo adresa e mediumit ku punojnë. Lajme të cilat nuk e kanë të qartë emrin e autorit dhe redaktorit të mediumit, nuk rekomandohen të merren si të vërteta.

**Burimet kredibile:** Lexuesit duhet të edukohet që gjatë leximit të informacioneve të kontrollojnë nëse burimet e cituara janë kredibile dhe nëse informacioni nga to mund të jetë i besueshëm.

**Shembull,** nëse në artikull citohet një shkencëtar apo historian, lexuesit duhet të kontrollojnë dhe të gjejnë të dhëna mbi kredibilitetin e tyre shkencor.

**Origjina e publikimit:** Materialet të cilat i lexojmë duhet të kenë një adresë të saktë në internet. Kjo nënkupton që adresat duhet të kenë të publikuar pronarin e mediumit, kolegjiunin e redaktorëve, burimin e financimit dhe stafin të cilin punon në të. Të dhënat për pronarin dhe burimet e financimit të medias i tregojnë lexuesit nëse lajmi është i hartuar për interesa të një grupi të caktuar.

**Fotografia dhe video:** Me pak vëmendje, lexuesi mund ta kuptojë nëse fotografitë janë reale apo janë të montuara. Situata e njëjtë ndodhë me video-materialet, ku prerjet e vrazhda të deklaratave mund të vërehen shumë lehtë nga konsumuesi i lajmit.

**Sponsorizimi:** Mediat janë të obliguara që artikujt e paguar dhe financuar nga bizneset dhe partitë politike t'i identifikojnë si materialet të sponsorizuara.

Nëse materialet e sponsorizuara nuk janë identifikuar si të tilla kjo vlerësohet shkelje e Kodit të Mediave. KMSHK në disa raste ka konstatuar se mediat kanë shkelur këtë obligim.

Vërtetimi i fakteve: Në botën ku çdokush ka në dorë mundësinë për të prodhuar lajm, pozicioni i gazetarëve ka nisur të ndryshojë nga raportues të lajmeve në kontrollues të fakteve dhe raportues të lajmeve të rreme. Në disa vende të botës, Facebook tashmë ka certifikuar media të cilat prodhojnë lajme dhe kontrollojnë lajme të mediave tjera, nëse kanë apo jo përmbajtje të vërtetë. Politika e rrjeteve sociale është që lajmet e tilla të cilat mbajnë mbishkrimin e "fact-checked" të promovohen dhe t'u jepet prioritet në shpërndarje.

## ZGJIDHJA LIGJORE

Në mbarë globin është hapur një diskutim i gjerë për mekanizmat ligjorë të cilët do ndëshkonin shpërndarjen e lajmeve të rreme. Në disa raste pronarët e rrjeteve sociale janë gjobitur nga shtetet për lejimin dhe tolerimin e shpërndarjes së materialeve të ndaluara.

Në Kosovë, baza ligjore sanksionon në disa forma shpërndarjen e informacioneve të ndaluara.

Shpërndarja e propagandës që nxit urrejtje dhe kryerjen e veprave penale është e dënueshme me Kodin Penal, ndërsa dënimet për vepra të tilla mund të kalojnë 15 vite burgim, nëse nxitja ka qenë për vepra penale të terrorizmit.

Ndjekja në rastet penale kryhet në dy forma, me paraqitjen e rastit nga pala e dëmtuar, por edhe nga vet prokuroria, e cila në rastet kur hasë në vepra penale të kryera nga mediat duhet t'i ndjekë ato sipas

detyrës zyrtare. Mekanizmi tjetër i parandalimit të lajmeve të rreme zhvillohet përmes kontesteve civile sipas Ligjit mbi Shpifjen dhe Fyerjen.

Ky ligj e përcakton që autori i lajmit është përgjegjës për shpërndarjen e informacionit të cilin ai e ka ditur se është i pavërtetë, ose është dashur ta dijë se është i pavërtetë.

Mekanizmi garanton bazë të mirë ligjore për të ndjekur shpifjet, fyerjet dhe rrjedhimisht edhe lajmet e rreme. Megjithatë, mungesa e efikasitetit të gjykatave në trajtimin e lëndëve të shpifjes ka pamundësuar që mediet të cilat shpërndajnë lajme të tilla të ndëshkohen.

Mekanizmat tjerë të parandalimit të shpërndarjes së lajmeve të rreme janë Komisioni i Pavarur për Media (KPM) dhe KMSHK.

I pari trajton shkeljet etike nga mediat tradicionale si TV dhe Radio, ndërsa KMSHK ka në kompetencë të trajtojë shkeljet etike nga gazetatat dhe mediat online. Si organ vetërregullues, KMSHK funksion si mekanizëm parimor mbi mediat anëtare të cilat janë të obliguara t'i publikojnë impresiumet e tyre dhe t'i respektojnë parimet etike të KMSHK-së.

Në rast të shkeljeve të këtyre parimeve, mendimi i KMSHK-së është provë në gjykatë për trajtimin e rastit të shpifjes ose fyerjes.

Në anën tjetër, KPM është mekanizëm rregullues i cili derivon nga ligji. KPM imponon licenca për të gjitha radiot dhe televizionet që operojnë në Kosovë, ndërsa në rast të shkeljeve të Kodit të Etikës së KPM, Këshilli mund të shqiptojë ndëshkime në të holla për mediat (Tv dhe Radio) si dhe t'ua tërheqë licencat. Dy mekanizmat KPM dhe KMSHK mund të trajtojnë rastet me vetiniciativë ose me kërkesën e palëve.

